

20242564467

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA
NGA BANKA HUNGAREZE E EKSPORT-IMPORTIT, SHOQËRI PRIVATE ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR
FINANCIMIN BUXHETOR DHE FINANCIMIN E QËLLIMEVE TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut detyrohet nga Banka Hungareze e Eksport-Importit, shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me hua në vlerë prej 500.000.000 euro, e dedikuar për financim buxhetor dhe financim për qëllime të përgjithshme.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua, që do të nënshkruhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Hungareze të Eksport-Importit, shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 3

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të tërhiqet në një këst.

Afati për pagesë të huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej tre vjet.

Norma e interesit është fikse dhe është 3.25%.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Hungareze të Eksport-Importit, kompani private me përgjegjësi të kufizuar, për mjetet e patërhequra në shumën prej 0,5% të huas në vit.

Provizioni për mjetet e patërhequra do të llogaritet në baza ditore mbi pjesën e patërhequr të huas, e llogaritur nga data e disponueshmërisë së mjeteve dhe do të paguhet në ditën e parë të punës pas përfundimit të periudhës së disponueshmërisë.

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të paguhet me 24 këste gjashtëmujore, më 15 prill dhe 15 tetor çdo vit.

Neni 4

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen për hua nga neni 2 të këtij ligji do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.